


“ Programet studimore të ofruara në këtë njësi akademike reformohen duke i përcjellë trendet e fundit të zhvillimit të shkencës dhe teknologjisë në nivel botëror, duke iu përshtatur kërkesave të tregut vendor, rajonal e botëror. ”

Pranimet

Pranimet në Universitetin e Prishtinës bëhen nëpërmjet konkurseve publike. Çdo person i cili e ka përfunduar maturën shtetërore dhe i pëmbush kriteret e përcaktuara në konkursin për studentë të rinj, ka të drejtë të konkurrojë për t'u bërë pjesë e Universitetit tonë.



Rreth nesh

Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit është institucioni fillestar i shkencave teknike në vend, i cili trashëgon një histori mbi shtatë dekadash.

Të rinjtë që zgjedhin të studiojnë në FIN, mund të bëhen pjesë e departamenteve që ne ofrojmë, si: Konstruksioni, Hidroteknika, Gjeodezia dhe Inxhinieria e Mjedisit. Ata do të mund të përfitojnë shkathtësitë e nevojshme edhe në laboratorët bashkëkohorë të materialeve ndërtimore, asfaltit, gjeomekanikës, hidroteknikës, gjeodezisë dhe Inxhinierisë së mjedisit, që janë pjesë përbërëse e institutit të fakultetit.



Kontakti

Adresa:

Rr. "Agim Ramadani", p.n. 10 000
Prishtinë, Republika e Kosovës

Telefoni:

+383 (0)38 554 899

Email:

fin@uni-pr.edu

Webfaqja

<https://fin.uni-pr.edu/>



Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit

Kalendari akademik

15 janar	Përfundimi i ligjëratave (semestri dimëror)
15 janar – 15 shkurt	Provimet e semestrit dimëror
15 shkurt	Dita e Universitetit të Prishtinës
16 shkurt	Fillimi i semestrit veror
31 maj	Përfundimi i ligjëratave për vit akademik
Korrik	Konkursi për studimet bachelor
Shtator	Konkursi për studimet master
15 shtator	Përfundimi i vitit akademik
1 tetor	Fillimi i vitit akademik



Programet:

Bachelor

Inxhinieria e Ambientit (180 ECTS)

Konstruktiv (180 ECTS)

Gjeodezi (180 ECTS)

Master

Gjeodezi (120 ECTS)

Hidroteknikë (120 ECTS)

Konstruktiv (120 ECTS)

Pse n'Inxhinieri të Ndërtimit?

- Programet më unike të studimit – institucioni i vetëm i arsimit të lartë, ofertues i programeve studimore në Inxhinieri të Ndërtimit;
- Profesorë me përvojë dhe eminentë në fushat përkatëse;
- Mundësitë më të shumta për studime njësemestrale në universitete evropiane;
- Diplomë që njihet ndërkombëtarisht;
- Tarifa të ulëta studimi;
- Kampus atraktiv;
- Bursa për studentët me arritje të larta;
- Partneritete të shumta me tregun e punës, të cilat krijojnë mundësi për: punë praktike, vende pune dhe ngritje në karrierë;
- Të diplomuar me punësueshmëri të lartë.

